

## NË EMËR TË POPULLIT

P. nr.415/2017

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërci, në lëndën penale ndaj të pandehurit L.H. nga ..., për shkak të veprave penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 në lidhje me par. 1 të KPRK-së; Kanosja nga neni 185 par. 2 lidhur me par.1 të KPRK-së, e në bashkim real me veprën penale si nën pikën I të dispozitivit të aktakuzës; dhe, Shkelja e urdherit mbrojtës nga neni 25 i Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, e në bashkim real me veprat penale si nën pikën I dhe II të dispozitivit, duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.445/2017 të datës 27.06.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 16.01.2019, në mungesë të të pandehurit dhe prokurorit, me datë 17.01.2019 publikisht shpalli, ndërsa me datë 21.01.2019 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**L.H.**, nga i ati ... dhe e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me dt. ... në ..., ku edhe jeton, Rr. “...” Kati i ..., i martuar, minator, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme teknike, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

#### SEPSE:

**I.** Me datë 23.02.2017, rreth orës 15:00, në ..., komuna e ..., në shtëpinë e përbashkët familjare, i ka shkaktuar lëndime trupore personit tjetër, dhe atë bashkëshortes së tij – të dëmtuarës A.M., ashtuqë e dëmtuara pas lindjes së djalit tani një muajsh, derisa ende ishte e paaftë t'i kryej punët e shtëpisë për shkak të lehonisë, i pandehuri në shenjë revolte i drejtohet me fjalët: “ti nuk po i kryen punët e shtëpisë mirë” dhe të njëjtën e godet me grushta në trup dhe tenton ta marr rripin, e ku e dëmtuara në atë gjendje i gjunjëzohet duke i thënë, “mos më godit me rrip se ende e kam trupin varrë nga lindja”, dhe i pandehuri e len rripin dhe prap e godet me grushta në trup, me ç`rast i shkakton lëndime të lehta trupore, dhe atë: ndrydhje të indeve të buta të kokës, krahëve dhe parakrahëve, regjionit të shpinës dhe në të dy kofshët, lëndime këto me pasoja të përkohshme për shëndetin, si dhe tek e dëmtuara ka shkaktuar frikë dhe ankth për jetën e saj.

**Me këtë ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 në lidhje me par. 1 pika 1.4 të KPRK-ës.**

**II.** Me datën 11.06.2017, në orën e pacaktuar, përmes telefonit e ka kanosur personit tjetër se do ta gjejë ndonjë e keqe dhe atë të dëmtuarën A.M. – bashkëshorten e tij, duke i shkruar SMS, me fjalët: “të shtunën qitma djalin ta marr, dhe nëse nuk don e marr me zor dhe kam me ju q.. robt dhe çdo send që më del përpara kam me e kall dhe mshele gojën se vij e të kalli, mos thuaj nuk e kam ditë, mos fol asnjë fjalë hiq”, me çka ka shkaktuar frikë dhe ankth tek e dëmtuara.

**Me këtë ka kryer veprën penale: Kanosja nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, e në bashkim real me veprën penale si nën pikën I të dispozitivit.**

**III.** Në të njëjtën ditë, kohë dhe vend si nën pikën II të dispozitivit, i pandehuri ka thyer Urdhrin mbrojtës, të shqiptuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, me Aktvendimin C.nr.90/2017 të datës 08.03.2017, ku të pandehurit i është ndaluar që të dëmtuarën A.M. –

bashkëshorten e tij të mos e shqetësoj, kërcënoj ose të kryej ndonjë veprë të dhunës në familje ndaj saj dhe fëmijës së saj.

**Me këtë ka kryer veprën penale: Shkelja e urdhrin mbrojtës nga neni 25 i Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje, e në bashkim real me veprat penale si nën pikën I dhe II të dispozitivit.**

**Andaj Gjykatat ne baze te nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 49, 50, 51,52, 73, 80 të KPRK-se, dhe nenit 450, 460 të KPP-së, e:**

## **GJYKON**

**Për pikën I** të aktakuzës dhe aktgjykimit, për veprën penale: **Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 në lidhje me par. 1 pika 1.4 të KPRK-ës, i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale ne afat prej një (1) viti.**

**Për pikën II** të aktakuzës dhe aktgjykimit, për veprën penale: **Kanosja nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, i cakton dënim me gjobë në shumën prej 300 € (treqindë euro).**

**Për pikën III** të aktakuzës dhe aktgjykimit, për veprën penale: **Shkelja e urdhrin mbrojtës nga neni 25 i Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje, i cakton dënim me burg në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në raste se i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale ne afat prej një (1) viti.**

**Gjykata, në mbështetje të nenit 80 të KPRK-së, të pandehurit L.H., i:**

## **S H Q I P T O N**

- I. DËNIM UNIK ME BURGIM në kohëzgjatje prej tetë (8) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.**
- II. DËNIM UNIK ME GJOBË në shumë prej 300 € (treqindë euro) të cilën shumë bligohet ta paguaj brenda afatit prej tre (3) muajve, pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit. Në rast se i pandehuri nuk e paguan gjobën, atëherë kjo shumë e dënimit me gjobë i shndërrohet menjëherë në dënim me burgim sipas ligjit.**
- III. OBLIGOHET i pandehuri L.H., që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë për ekspertizën mjeko-ligjore shumë prej 20€, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumë prej 30€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.**
- IV. Pala e dëmtuar A.M. për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil-juridik.**

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.445/2017 të datës 27.06.2017, kundër të pandehurit L.H. nga ..., për shkak te veprave penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 në lidhje me par. 1 të KPRK-së; Kanosja nga neni 185 par. 2 lidhur me par.1 të KPRK-së, e në bashkim real me veprën penale si nën pikën I të dispozitivit të aktakuzës; dhe, Shkelja e urdherit mbrojtës nga neni 25 i Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje, e në bashkim real me veprat penale si nën pikën I dhe II të dispozitivit.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ashtu që në këtë seancë i pandehuri: e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, duke theksuar se e ndjej veten fajtor për veprën penale që i vihet në barrë si dhe ka shprehur keqardhje për atë që ka ndodhur dhe ka premtuar se nuk do të kryej sjellje të tilla në të ardhmen.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se i pandehuri e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe se janë plotësuar te gjitha kushtet ligjore për pranimin e fajësisë dhe i propozon gjykatës që ta pranojë pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe ta merr parasysh pranimin e fajësisë si rrethane lehtësues me rastin e shqiptimit te dënimit.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë te cilën e ka deklaruar i pandehuri L.H., e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Raportet policore të datës 23.02.2017; Raporti mjekësor në emër të dëmtuarës A.M., nr. 2370, i datës 23.02.2017; Mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr. F.B. për të dëmtuarën, i datës 14.06.2017; Foto-dokumentacioni e përpiluar në vendin e ngjarjes; Deklarata e të pandehurit dhënë në polici, e datës 23.02.2017; Deklarata e të dëmtuarës A.M. e dhënë në polici, e datës 23.02.2017 dhe 12.06.2017; Ekstraktin nga dosja penale për të pandehurin; Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë C.nr.90/2017 dt.08.03.2017. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimin te fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri L.H., ka kryer veprat penale që i vihen në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimin të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri L.H..

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit L.H. dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprat penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 në lidhje me par. 1 të KPRK-së; Kanosja nga neni 185 par. 2 lidhur me par.1 të KPRK-së, e në bashkim real me veprën penale si nën pikën I të dispozitivit të aktakuzës; dhe, Shkelja e urdherit mbrojtës nga neni 25 i Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje, e në bashkim real me veprat penale si nën pikën I dhe II të dispozitivit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe renduese për matjen e dënimit ne mbështetje të nenit 73 të KPK-ës. Si rrethana renduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale gjë që nga provat rezulton se i pandehuri

këtë vepër e kishte kryer me dashje, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e që kjo vepër penale ka qellim të mbrojë jetën dhe trupin e individit, rrethanat më të cilat është kryer vepra po ashtu gjykata e ka vlerësuar si rrethanë rënduese.

Si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprat penale, faktin se i njëjti ka shprehe keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, duke premtuar se në të ardhmë nuk do të përsërisë sjelljet e njëjta, sjellja korrekte e të pandehurit në gjykatë, ne raport me gjykatë dhe palët, si dhe faktin kjo vepër penale ka ndodhur në vitin 2017 dhe se nga deklarimi i palëve në seancë, raportet mes tyre janë përmirësuar, jetojnë bashkë si bashkëshortë si dhe kanë edhe një fëmijë pas ndodhjes së kësaj vepre. Këto tregojnë se raportet mes tyre janë përmirësuar.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me burg me kusht dhe dënimit me gjobë, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Poashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par 1 të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata ka udhëzuar palën e dëmtuar në kontest të rregullt civil, konform nenit 463 të KPP-së.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.415/2017 dt.21.01.2019**

Procesmbajtësja:  
Selvije Kostërci

**Gjyqtari**

\_\_\_\_\_  
Rrahman BEQIRI

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjyaktës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.